

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit K. D., nga fshati M., Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2598/2015 të datës 28.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me datë 29.12.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K. D., nga i ati G. dhe nëna N. e lindur C., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin M., Komuna e P., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 24.08.2015 rreth orës 18,00 minuta, pikërisht në vendin e quajtur, Njësia Ekonomike “P. 1”, pjesë e territorit mbrojtës “Gj.”, është hasur duke prerë 15 copë dru, të llojit ahu dhe shkozë, me sopat dhe me motor sharrë, me diametër 12/26 cm, me gjatësi prej 10/18 m, me vëllim të përgjithshëm 4,29 m³, duke e kapur me qerre traktor Ferguson, me ç’ rast Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Autoritetit Komunal Pyjor – Prizren, njësisë ekonomike “P. 1”, i shkakton dëm material,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52 al.5, 73, 74, 75, 76 dhe 358 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale, dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

E dëmtuara: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural – Autoriteti Komunal Pyjor në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2598/2015 të datës 28.01.2015, kundër të akuzuarit K. D., nga fshati M., Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 29.12.2016, prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës deklaroi se pas konsultimit me sekretaren juridiken të prokurorit të çështjes, është vërtetuar se është lëshuar një gabim teknik me rastin e përpilimit me shkrim të aktakuzës, ku në vend të datës 28.01.2015 duhet të jetë data 28.01.2016, ndërsa në pjesën tjetër aktakuza mbetet e pa ndryshuar.

Prokurori i shtetit Elfete Purova në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: mbës në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.2598/2015 të datës 28.01.2016, të parashtruar ndaj të pandehurit K. D., nga fshati M., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par.2 të KP-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari K. D., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, këtë pranim e bëj për arsye që jam momentalisht përkohësisht në botën e jashtme, ku edhe punoj për të siguruar ekzistencën e familjes sime. Është fakt që unë me datën 23.08.2015, jam hasur nga zyrtarët e autoritetit komunal pyjor në Prizren në prerjen e druve, por dua të theksoj që unë për të njëjtin rast jam shpallur fajtor dhe jam dënuar mu nga kjo gjykatë me aktgjykimin P.nr.1516/2015 të datës 07.10.2015, aktgjykim ky i plot fuqishëm me datë 18.02.2016, por pas pranimit të ftesës nga ana e gjykatës për shqyrtim unë në shqyrtimin e parë fillestar nuk e kam pranuar fajësinë, nga të cekurat më lart, dhe kam kërkuar ballafaqimin edhe me përfaqësuesin e autoritetit pyjor komunal si parashtrues të kallëzimit penal edhe me rojën e pyllit, por duke pasur parasysh që sot të njëjtit nuk janë paraqitur në shqyrtim, e duke pasur parasysh që për shkak të mungesës së tyre do të prolongohet kjo çështje penale, e unë si thashë në fillim jam përkohësisht në botën e jashtme, nga të cekurat theksoj që e pranoj veprën penale, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, të cekurat më lart, rrethanat e mia personale dhe familjare që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe me punën time të përkohshme në botën e jashtme kujdesem për sigurimin e ekzistencës të familjes sime, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj

gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datën 24.08.2015 rreth orës 18,00 minuta, pikërisht në vendin e quajtur ..., Njësia Ekonomike "P. 1", pjesë e territorit mbrojtës ..., i akuzuari është hasur duke prerë 15 copë dru, të llojit ahu dhe shkozë, me sopat dhe me motor sharrë, me diametër 12/26 cm, me gjatësi prej 10/18 m, me vëllim të përgjithshëm 4,29 m³, duke e kapur me qerre traktor Ferguson, me ç' rast Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Autoritetit Komunal Pyjor – Prizren, njësisë ekonomike "P. 1", i shkakton dëm material,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i tre fëmijëve, bujk, mbajtës i familjes, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër penale si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim po ashtu nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.215/2016 me datë 29.12.2016

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.